



Republika e Kosovës



Komuna e Dragashit

RAPORTI I RALIZIMIT TË BUXHETIT JANAR- SHTATOR 2018

Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim

2018
TETOR
DRAGASH

RAPORTI

MBI REALIZIMIN E BUXHETIT PËR PERIUdhËN JANAR-SHTATOR 2018

Raportimi financiar në baza periodike është obligim ligjor i çdo subjekti të sektorit publik dhe bazohet në dispozitat e nenit 45 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 45.4 i këtij ligji obligon Kryetarin e Komunës që të përgatisë dhe dorëzojë në Kuvend raportet periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal brenda afatit prej 30 ditësh nga përfundimi i periudhës raportuese.

INFORMACIONE MBI BUXHETIN

Buxheti i komunës për vitin buxhetor 2018 i miratuar nga asambleja komunale është pjesë e pasqyrave tabelare të paraqitura në Ligjin mbi Buxhtin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Buxheti fillestar i komunës për vitin 2018 arrinë shumën prej 8,069,990.00 euro, nga kjo shumë 7,511,138.00 euro janë nga Fondi i Përgjithëshëm-Granti Qeveritar, ndërsa pjesa tjetër prej 460,657.00 janë mjete të buxhetuara nga të hyrat vetanake, si dhe nje pjesë janë nga huamarrja prej: 98,195.00 euro (Këtë hua nuk e ka marrë Komuna por Ministria e Arsimit dhe Shëndetsisë nga Banka Botërore për t'i ndihmuar disa komuna të Kosovës, njëra prej tyre është dhe Komuna e Dragashit).

Pjesë e Buxhetit Komunal janë dhe të hyrat vetanake të pashpenzuara dhe të bartura nga viti paraprak në shumën prej 637,935.10 euro.

Po kështu, në buxhetin e vitit 2018 janë bartur edhe 13,028.65 euro mjete të pashpenzuara në vitin 2017 të cilat i përkasin donatorve.

Tabela nr.1 Buxheti aktual sipas burimeve

BURIMET E FINANCIMIT TË BUXHETIT	2018	2017	%
1.Fondi i Përgjithëshëm	7,511,138.00	6,799,239.00	110.47
2.Të hyrat vetanake të buxhetuara	460,657.00	751,675.00	61.28
3.Të hyrat e bartura nga viti paraprak	637,935.10	530,286.25	120.30
4.Unioni Europian	1,817.70	1,817.70	100.00
5.UNDP	3,847.98	3,847.98	100.00
6.Komisioni Europian	7,362.97	7,362.97	100.00
7.Huamarrjet në Arsim Shendetsi	98,195.00		
8.Qeveria Japoneze		70,300.00	
TOTALI I BUXHETIT AKTUAL	8,720,953.75	8,164,528.90	106.82

Buxheti total i periudhës raportuese në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është më i lartë për 6.82%, Fondi i Përgjithshëm ka një rritje prej 10.47%, ndërsa të hyrat vetanake kanë një ulje prej 38.72%, dhe të hyrat e bartura në vitin 2018 në shkallë prej 20.30% me të larta se viti paraprak.

Shikuar sipas strukturës Fondi i Përgjithshëm në shumën totale të buxhetit për vitin 2018 ka një pjesëmarrje prej 86,13%, të hyrat vetanake (të buxhetuara dhe të bartura) 12,60% , huamarrja me pjesëmarrje 1.12 % dhe donatorët 0.15%

Tabela nr.2 Shpërndarja e buxhetit në kategori buxhetore

KATEGORITË BUXHETORE	2018	2017	%
1.Paga dhe shtesa	4,530,878.57	4,234,301.57	107.00
2.Mallra dhe sherbime	942,880.23	759,871.95	124.08
3.Sherbime komunale	130,000.00	130,000.00	100.00
4.Subvencione dhe transfere	24,881.00	34,663.00	71.78
5.Shpenzime për investime kapitale	3,092,313.95	3,005,692.38	102.88
TOTALI I BUXHETIT TË SHPËRNDARË	8,720,953.75	8,164,528.90	106.82

Duke shikuar tabelën nr.2 mbi shpërndarjen e buxhetit në kategori buxhetore, kategoria buxhetore pagat dhe shtesat në krahasim me periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak është më e lartë për 7%, mallrat dhe shërbimet për 24.08%, shërbimet komunale janë të njëjta si vitit paraprak , subvencionet dhe transferet janë më të ulta për 28.22% dhe shpenzimet kapitale kanë një ngritje prej 2.88%.

Në strukturën e buxhetit sipas kategorive buxhetore, pagat dhe shtesat kanë një pjesëmarrje prej: 51,95%, mallrat e shërbimet 10.81%, shërbimet komunale 1,49%, subvencionet dhe transferet 0,29% dhe shpenzimet për investime kapitale 35.46%.

SHPENZIMET BUXHETORE

1.Pagat dhe shtesat

Nr	PARASHIKIMI	Janar-Shtator 2018	Janar-Shtator 2017	%
1	Paga neto permes listes së pagave	2,808,072.02	2,735,728.59	102.64
2	Pagesa per sindikate	8,657.54	7,374.77	117.39
3	Antarsimi-oda e infermjerve të Kosovës	1,075.30		
4	Tatimi i ndalur ne paga	158,851.12	150,636.16	105.45
5	Kontributi pensional i punëtorit	156,646.27	151,425.57	103.45
6	Kontributi pensional i punëdhënësit	156,646.27	151,425.57	103.45
7	Antarsimi-oda e mjekve të Kosovës	748.50		
	TOTALI	3,290,697.02	3,196,590.66	102.94

Për periudhën raportuese kategoria e pagave dhe shtesave krahasuar më të njëjten periudhë të vitit paraprak është me një rritje prej 2.94%.

Kjo kategori buxhetore duke pasur për bazë shumën e buxhetuar për paga dhe shtesa është realizuar në shkallë prej 73% .

2.Shpenzimet për mallra dhe shërbime

Kategoria buxhetore për mallra dhe shërbime sipas buxhetit për vitin 2018 është buxhtuar në shumën totale prej 942,880.23 euro nga të gjitha burimet e financimit (Fondi i Përgjithshëm, nga Huamarrjet si dhe ato të bartura nga viti 2017 në 2018 dhe nga fondet e donatorëve).

Shpenzimet për mallra e shërbime nga Fondi i Përgjithshëm janë buxhetuar në shumën prej 750,252.00 euro, nga huamarrjet 91,554.00 euro nga të hyrat e bartura të vitit paraprak 89,055.15 euro dhe nga fondet e donatorëve 12.019,08 euro.

Në periudhën Janar-Shtator 2018 , duke pasur për bazë të gjitha burimet e financimit, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar në shumën totale prej 355,745.19 euro. Kjo shumë e realizuar në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar për mallra dhe shërbime është më e lartë prej 35.78%.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura shpenzimet për mallra dhe shërbime sipas burimeve të financimit dhe destinimit të tyre – sipas kodeve ekonomike.

Tabela nr.3 Shpenzimet për mallra e shërbime sipas burimeve dhe kodeve ekonomike

Kodet ek.	Lloji i shpenzimit	Fondi i Përgjithshëm m 10	Të hyrat vetanake fondi 21	Të hyrat vetanake 22	Fondi i donatorëve	TOTALI
13130	Shpen. E udht.zyrtar brenda vendit	1,598.90				1,598.90
13133	Shpen.tjera te udhtimi zyrtar brenda vendit	1,442.39				1,442.39
13140	Shpenz. E udhëtimit jasht vendit	6,670.80				6,670.80
13141	Meditje udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,633.20				1,633.20
13310	Shpenzimet për internet	2,663.81				2,663.81
13320	Shpenzimet e tel.mobile	16,083.79				16,083.79
13330	Shpenzimet postare	418.40				418.40
13340	Shpenzimet e kabll optike	84.00				84.00
13450	Sherbimet e shtypit jo marketingut	379.70				379.70
13460	Sherbimet tjera kontraktuese	67,594.46		800.00		68,394.46
13470	Sherbimet teknike	10,211.65				10,211.65
13480	Shpenzimet për anëtarësim	7,399.70				7,399.70
13490	Shpenzimet e varrimit	7,166.00				7,166.00
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	10,541.59				10,541.59
13502	Telefona (me pak se 1000 euro)	40.00				40.00
13503	Kompjuter me pak se 1000 euro	10,842.00				10,842.00
13506	Pajisje speciale mjeksore 1000 euro	92.60				92.60
13509	Pajisje tjera më pak se 1000 euro	14,993.29				14,993.29
13610	Furnizime me mat.zyre	22,307.23				22,307.23
13620	Furnizime me ushqim e pije	8,538.47				8,538.47
13630	Furnizime mjeksore	19,815.62				19,815.62
13640	Furnizime pastrimi	6,939.40				6,939.40
13650	Furnizime me veshmbathje	2,060.40				2,060.40
13710	Vaj	98.30				98.30
13720	Naftë për ngrohje qendrore	5,012.76				5,012.76
13750	Qymyr					
13760	Dru	7,902.50				7,902.50
13770	Derivate për gjenerator	3,578.42				3,578.42
13780	Karburante për vetura	40,165.31				40,165.31
13810	Avanse per para te imta (P.CASH)	5,000.00				5,000.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	2,598.53				2,598.53
13951	Sigurimi i automjeteve	1,942.56				1,942.56
13952	Taksa komunale e regjistrimit autom.	84.00				84.00
14010	Mirembajtja e riparimi i autom.	16,903.85				16,903.85
14020	Mirëmbajtja e ndertesave	3,434.65				3,434.65
14023	Mirëmbajtja e shkollave	16,329.59				16,329.59
14040	Mirëmbajtje e tek.informative	2,682.60				2,682.60
14050	Mirembajtja e mobiljeve e pajisjeve	1,173.70				1,173.70
14060	Mirembajtja rutinore	8,352.40				8,352.40
14210	Reklama dhe konkurse	2,222.90				2,222.90
14220	Botimet e publikimeve	659.10				659.10
14230	Shpenzimet e inf.publik	3,715.00				3,715.00
14310	Dreka zyrtare	5,892.93				5,892.93
14410	Shpenzimet-vendimet e gjykatave	7,678.69				7,678.69
	TOTALI	354,945.19		800.00		355,745.19

Tabela nr.4 Shpenzimet per mallra e sherbime sipas viteve

Kodi	Lloji i shpenzimit	2018	2017	2016	%
13130	Shpenzimet e udhëtimit në vend	1,598.90	3,290.36	5,885.98	48.59
13131	Meditjet e udhëtimit zyrt.ne vend			5,025.00	
13132	Akomodimi gjatë udht.zyrtar brenda vendit		-	875.00	
13133	Shpenzimet tjera te udhet.ne vend	1,442.39	-	1,679.07	
13140	Shpenzimet e udhëtimit jasht vendit	6,670.80	12,751.51	6,139.00	
13141	Meditjet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	1,633.20	-	2,581.60	
13142	Akomodimi i udht.zyrtare jasht vendit		-	3,430.00	
13310	Shpenzimet për internet	2,663.81	817.93	1,452.77	325.68
13320	Shpenzimet tjera tel.mobil	16,083.79	14,131.95	13,202.96	113.81
13330	Shpenzimet postare	418.40	311.10	757.80	134.49
13340	Shpenzimet per perdorimin e kab.optik	84.00	-	161.94	-
13410	Sherbimet e arsimit dhe trajnimit		-	0.00	-
13430	Sherbimet shendetësore		-	817.60	
13450	Sherbimet e shtypit jo marketingut	379.70			
13460	Sherbimet kontraktuese	68,394.46	35,036.88	35,849.60	195.21
13470	Sherbimet teknike	10,211.65	868.80	229.60	1,175.37
13480	Sherbimet e anetaresimit	7,399.70	1,699.86	2,549.79	435.31
13490	Shpenzimet e varrimit	7,166.00			
13501	Mobilje më pak se 1000 euro	10,541.59	99.85	2,618.90	
13502	Telefona me pak se 1000 euro	40.00			
13503	Kompjuter më pak se 1000 euro	10,842.00	2,451.50	5,571.50	442.26
13506	Paisje speciale mjeksore 1000 euro	92.60			
13509	Pajisje tjera	14,993.29	6,967.30	11,076.10	215.20
13610	Furnizime me mat.zyre	22,307.23	20,037.12	26,289.16	111.33
13620	Furnizime me ushqim dhe pije	8,538.47	3,285.20	7,651.95	259.91
13630	Furnizime mjeksore	19,815.62	7,460.58	6,701.57	265.60
13640	Furnizime pastrimi	6,939.40	6,555.47	4,802.25	105.86
13650	Furnizime me veshmbathje	2,060.40	600.00	1,920.00	343.40
13710	Vaj	98.30	-	0.00	-
13720	Naftë për ngrohje qendrore	5,012.76	33,032.84	10,168.02	15.18
13750	Qymyr		13,169.22	1,238.39	0.00
13760	Dru	7,902.50	10,369.45	573.72	76.21
13770	Karburante për gjenerator	3,578.42	314.00	2,492.81	1,139.62
13780	Karburante për automjete	40,165.31	42,171.33	34,368.28	95.24
13810	Avanse per para të imta (P.CASH)	5,000.00			
13950	Regjistrimi i automjeteve	2,598.53	2,966.12	6,877.66	87.61
13951	Sigurimi i automjeteve	1,942.56	3,485.72	-	-
14010	Mirëmbajtja dhe rip.automjeteve	16,903.85	15,018.86	17,436.72	112.55
13952	Taksa komunale e regjistrimit te automjetve	84.00			
14020	Mirëmbajtja e ndertesave	3,434.65	1,445.90	2,734.83	237.54
14023	Mirembajtja e shkollave	16,329.59		11,786.66	
14040	Mirëmbajtja e tek.informative	2,682.60	2,033.50	3,051.40	131.92
14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	1,173.70	1,967.00	2,679.90	59.67
13460	Mirembajtja rutinore	8,352.40	2,805.00	-	-
14210	Reklamat dhe konkurset	2,222.90	955.00	16,366.60	232.76
14220	Botimi i publikimeve	659.10	1,033.10	2,361.90	63.80
14230	Shpenzimet për informim publik	3,715.00	4,369.50	4,256.00	85.02
14310	Drekat zyrtare	5,892.93	7,518.80	17,648.80	78.38
14410	Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore	7,678.69	2,978.00	3,269.10	-
	TOTALI	355,745.19	261,998.75	284,579.93	135.78

Shpenzimet për mallra dhe shërbime në periudhën raportuese janë realizuar në shumën totale prej 355,745.19 euro. Këto shpenzime janë më të larta se ato të periudhës së njëjtë raportuese të vitit paraprak për 35.78%.

Tabela nr.5 Shpenzimet për Shërbime Komunale

Kodi ek.	LLOJET E SHPENZIMVE	2018	2017	2016	%
13210	Shpenzimet e energjisë elektrike	40,613.10	45,631.32	44,070.06	89.00
13220	Shpenzimet për ujë	13,583.31	7,806.74	9,073.52	173.99
13230	Shpenzimet për mbeturina	19,785.98	11,134.32	15,436.69	177.70
13250	Shpenzimet për tel.fiks	2,560.74	2,907.18	2,962.47	88.08
	TOTALI	76,543.13	67,479.56	71,542.74	113.43

Shpenzimet komunale për periudhën raportuese janë realizuar në shumën prej 76,543.13 euro dhe janë më të larta se shpenzimet e realizuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak për 13.43%.

Tabela nr.6 Subvencionet dhe Transferet

Kodi ek.	LLOJET E SUBVE. TRANSFER.	2018	2017	2016	%
21110	Subvencione per entitete publike	4,500.00	1,950.00	4,550.00	230.77
21200	Subvencione per enitete jo pulike	2,000.00	4,380.00		-
22200	Subvencione për perfituesit indiv.	17,700.00	19,615.00	8,665.00	90.24
	TOTALI	24,200.00	25,945.00	13,215.00	93.27

Në emër të subvencioneve dhe transfereve, në periudhën Janar-Shtator 2018 është paguar shuma prej 24,200.00 euro që është më e ulta se në periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak për 6,73%. Nga kategoria e subvencioneve në këtë periudhë, kanë përfituar më shumë etnitete publike se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Tabela nr 7 Shpenzimet për Investime Kapitale Janar – Shtator-2018

SHPENZIMET PER INVESTIME KAPITALE		2018	2017	%
Kodet	Pagesat nga Grantet-te hyrat fondi 10-21-22			
31121	Objektet arsimore	96,404.60	78,170.92	123.33
31122	Objektet shendetesore	-	-	-
31230	Ndërtimi i rrugëve	659,212.23	232,551.99	283.47
31250	Kanalizimi	100,263.40	-	-
31260	Ujsjellsi	78,352.15	19,369.50	404.51
31270	Mirbajtje e investimve		21,762.80	
31660	Pajisje speciale mjeksore	-	70,300.00	-
31690	Pajisje tjera	14,450.00		
31703	Vetura e ndimes se shpejt	39,800.00		
32100	Shpronësimi i tokave	1,912.50		
33100	Transfer i kapitalit per en.publike	26,500.00	11,000.00	240.91
33200	Transfer i kapitalit per jo.publike	37,460.00		
TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE		1,054,354.88	433,155.21	243.41

Shpenzimet për investime kapitale në periudhën raportuese janë realizuar vetëm 1,054.354.88 euro dhe ate nga: objekte arsimore, ndërtimi i rrugëve, kanalizim, shpronësim të tokave, transaksione kapitale jo publike dhe publike. Bazuar në raportet e gjeneruara nga sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit– Free balance, investimet kapitale të financuara nga Fondi i Përgjithshëm dhe të hyrat vetanake, mund të vërehet se në periudhën raportuese janë realizuar këto projekte si në tabelën nr.7. Realizimi i projekteve kapitale është 143.41% me shumë se viti paraprak

Tabela nr.8 Përmbledhja e shpenzimeve të periudhës Janar – Shtator-2018

Nr	Kateooritë buxhetore	2018	2017	2016	%
1	Pagat dhe shtesat	3,290,697.02	3,196,590.66	3,184,261.09	102.94
2	Mallrat e shërbimit	355,745.16	261,998.75	284,579.93	135.78
3	Shërbimet komunale	76,543.13	67,479.56	71,542.74	113.43
4	Subvencionet dhe transferet	24,200.00	25,945.00	13,215.00	93.27
5	Investimet kapitale	1,054,354.88	433,155.21	716,126.04	243.41
	TOTALI	4,801,540.19	3,985,169.18	4,269,724.80	120.49

Nga prezentimi i të dhënave në tabelen nr.8 vërehet se shuma totale e shpenzimeve sipas kategorive buxhetore është më e lartë se ajo e periudhës së njëjtë raportuese të vitit paraprak për 20.49%. Në këtë rritje kanë ndikim të madh disa projekte nga shpenzimet për investime kapitale si dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime, shërbime komunale dhe subvencione.

Shkalla e realizimit të buxhetit në raport me shpenzimet totale të periudhës raportuese arrin në 55%, që krahasuar me periudhën kjo shkallë e realizimit të buxhetit është e nivelit të mesëm.

TE HYRAT VETANAKE

Sipas vendimit mbi buxhetin, të hyrat vetanake për Vitin Buxhetor 2018 janë buxhetuar në shumën prej 460,657.00 euro. Sa i përket periudhës raportuese të hyrat vetanake janë realizuar në shumën prej 299,789.10 euro, që paraqet 65% e mjeteve të planifikuara për të hyra vetanake. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, këto të hyra janë realizuar më pak për 10.67 % ose shprehur në shumën absolute këto të hyra janë më të ulta se ato të periudhës së njëjtë raportuese të vitit paraprak për 35,812.90 euro.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur llojet e të hyrave vetanake duke krahasuar me të hyrat vetanake të vitit paraprak.

Nr	LLOJET E TË HYRAVE	2018	2017	2016	%
1	Tatimi ne pronë	134,460.82	171,717.96	175,558.21	78.30
2	Taksa mbi regj. E automjeteve	32,615.00	31,910.00	31,110.00	102.21
3	Taksa per leje ndertimi	837	-	-	-
4	Taksa mbi regjistrimin e trashigimisë	22,550.00	12,943.00	17,656.00	174.23
4	taksa mbi ndrrimin e dest.te tokes		-	-	-
5	Taksa per çertifikata te lindjes	1,186.00	703.00	12,976.00	168.71
6	Taksa per çertifikata te kurorizimit	1,672.00	1,312.00	2,735.00	127.44
7	Taksa per çertifikata te vdekjes	1,316.00	1,001.00	1,408.00	131.47
8	Taksa tjera te ofiqarisë	20,045.50	18,919.00	4,363.00	105.95
9	Taksa mbi verifikimin e dok, te ndr.	5,915.00	4,729.00	4,664.00	125.08
10	Taska mbi fotokopjen e dokument.	140.00	65.00	196.00	215.38
11	Taksa per fletekerkese-lutje	2,494.00	3,716.21	4,769.00	67.11
12	Licenta tjera per afarizem	2,724.62	6,514.93	11,173.67	41.82
14	Qiraja nga objektet publike	16,873.33	11,889.24	18,608.20	141.92
15	Licenca per regj, e biznesit		65	175	0.00
16	Licencat ndertimore	201.12	17,168.48	3,675.15	1.17
17	Te hyrat nga inspektimi veterinar	650.00	320.00	-	-
18	Gjobat ne trafik	34,376.50	22,261.00	15,235.00	154.42
19	Gjobat e trafikut te shq.nga Gjykata	665.00	7,955.00	7,855.00	8.36
20	Nga Agjencioni Pyjor e Kosovës	5,989.54	8,038.10	7,348.58	74.51
21	Te hyrat nga shitja e materjalit	728.67		248.00	-
22	Participimi ne shendetesi	14,349.00	14,375.00	15,571.50	99.82
	TOTALI	299,789.10	335,602.92	335,325.31	89.33